

KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY
(Për Biznese dhe Sipërmarrje)

KETO AFATE DHE KUSHTE (KJO “**MARREVESHJE**”) FORMOJNE NJE MARREVESHJE LIGJORE NDERMJET JUSH DHE BLACKBERRY.

“**BLACKBERRY**” nënkupton:

- (1) Atje ku adresa juaj kryesore është në Kanada, Amerikën e Jugut ose kudo që nuk përmendet në (2) deri në (4) më poshtë, BlackBerry me Përgjegjësi të Kufizuar.
- (2) Atje ku adresa juaj kryesore është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Korporata BlackBerry.
- (3) Atje ku adresa juaj kryesore është në Evropë (përfshirë Grinlend), Lindjen e Mesme ose Afrikën ose Federatën Ruse, BlackBerry UK me Përgjegjësi të Kufizuar.
- (4) Atje ku adresa juaj kryesore është në Azinë e Paqësorit (përfshirë Pakistanin, Sri Lankën, Kazakistanin, Kirgistanin, Taxhikistanin, Turkmenistanin dhe Uzbekistanin), BlackBerry Singapore Pte me Përgjegjësi të Kufizuar.

DUKE KLIKUAR NE BUTONIN “**PRANOJ**” TREGONI SE: (A) PRANONI PER LLOGARINE TUAJ DHE PER LLOGARINE E SECILES NJESI NE PERFITIMIN E TE CILES VEPRONI (SE BASHKU “**JU**” OSE “**JUAJ**”) KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY (SIÇ PERKUFIZOHEN ME POSHTE NE PJESEN 2); (B) NUK MUND TE PERDORNI SHERBIMET (SIÇ PERKUFIZOHEN ME POSHTE KETU) PA PRANUAR FILLIMISHT KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY; DHE (C) NESE JENI NJE BANOR NE NJE JURIDIKSION JASHTE AMERIKES SE JUGUT DHE QENDRORE, SE NUK JENI NJE KONSUMATOR SIÇ PERKUFIZOHET NGA LEGJISLACIONI NE JURIDIKSIONIN TUAJ. NESE KENI NDONJE PYETJE OSE SHQETESIM NE LIDHJE ME KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY, JU LUTEMI KONTAKTONI BLACKBERRY NE LEGAL@BLACKBERRY.COM. NESE, PERPARA SESA TE PERDORNI SHERBIMET: (A) VENDOSNI SE NUK JENI TE GATSHEM TE PRANONI KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY, MOS KLIKONI MBI “**UNE PRANOJ**”; OSE (B) NESE KENI KLIKUAR TASHME “**UNE PRANOJ**”, JU LUTEMI KONTAKTONI BLACKBERRY NE LEGAL@BLACKBERRY.COM PER TE INFORMUAR BLACKBERRY SE DESHIRONI TU JEPNI FUND KUSHTEVE TE SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY DHE NUK DO TE PERDORNI SHERBIMET. BLACKBERRY DHE JU JENI SECILI NJE “**PALE**” DHE SE BASHKU “**PALET**” E KUSHTEVE TE SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY.

1. Ju falënderojmë për interesin tuaj në Shërbimet e Biznesit të BlackBerry (“**Shërbimet**”). BlackBerry do të kryejë nivelin e ndihmës teknike ose Shërbimet e tjera të përcaktuara në porosinë tuaj për kohëzgjatjen e porositur, duke iu nënshtruar kushteve të Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry, për numrin e kopjeve dhe të Softuerit (të përkufizuar më poshtë) të identifikuar në porosinë tuaj. Nëse produktet ose shërbimet e tjera të BlackBerry përfshijnë ndihmë teknike, atëherë do të zbatohet kjo Marrëveshje. Duhet të keni dijeni se Shërbimet mbulojnë vetëm Softuerin e BlackBerry ose një pjesë të tij në varësi të Shërbimit të blerë. Nëse dëshironi Shërbime për çdo produkt harduer të BlackBerry, ju lutemi referojuni Garancisë së Kufizuar të BlackBerry se kë të kontaktoni në lidhje me atë produkt harduer të BlackBerry. Softueri i BlackBerry (“**Softuer**”) nënkupton dhe përfshin, por nuk është i kufizuar në, ndonjë nga BlackBerry Handheld Software, BlackBerry PC Software ose BlackBerry Server Software që u janë dhënë me licensë sipas Marrëveshjes së tanishme të Licensës të Zgjidhjeve të BlackBerry ose një marrëveshje tjetër, në cilëndo formë, mjet ose mënyrë të siguruar ose të instaluar ose përdorur më pas. Termi “Softuer” nuk do të përfshijë ndonjë aplikim të softuerit që është pronë e një pale të tretë (“**Softueri i Palës së Tretë**”), pavarësisht nëse Softueri i Palës së Tretë shoqëron, sigurohet me ose funksionon në lidhje me, Softuerin dhe/ose ndonjë softuer tjetër ose pajisje të dorës të palëve të treta, përveç softuerin,

ndërfaqeve dhe firmuerit të licënsuar nga BlackBerry nga një palë e tretë për përfshirjen në një produkt të BlackBerry dhe të shpërndarë si një pjesë përbërëse e atij produkti BlackBerry sipas një marke të BlackBerry. Disa produkte të tjera mund të përfshijnë ndihmë teknike dhe nëse po, do të zbatohen këto Shërbime të BlackBerry sipas Kushteve të BlackBerry.

2. BlackBerry do t'ju sigurojë Shërbimet në përputhje me Përshkrimin përkatës të Programit të Shërbimit, ("Shërbimet e Biznesit sipas Përshkrimit të Programit të BlackBerry") të vendosur në <http://www.blackberry.com/supportprogramdescriptions> që ka lidhje me porosinë tuaj, kuotimin (nëse u është siguruar një juve nga BlackBerry), hollësitë dhe kushtet e shërbimit të përshkruara në një njësi të mbajtjes së stokut ("SKU") të porositur dhe këtë Marrëveshje përfshirë ndonjë kusht të përfshirë në këtë Marrëveshje nga Marrëveshja e Licënsës të Zgjidhjeve të BlackBerry që keni nënshkruar. Kjo Marrëveshje merr përparësi mbi Përshkrimin e Programit të Shërbimeve të Biznesit nga BlackBerry që zbatohet për Shërbimet e caktuara të porositura dhe Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry zëvendësojnë dhe marrin përparësi mbi të gjitha komunikimet dhe dokumentat e mëparshme si të shkruara ashtu edhe me gojë që kanë lidhje me ndihmën teknike ose Shërbimet e tjera të zbatueshme. Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry mund të ndryshohen vetëm më shkrim të nënshkruar nga ju dhe BlackBerry. Shërbimet do të sigurohen nga BlackBerry në anglisht përveç ku cilësohet posaçërisht ndryshe në Shërbimet përkatëse të Biznesit nga Përshkrimi i Programit të BlackBerry . Mund t'i përdorni Shërbimet vetëm për përdorimin tuaj të brendshëm dhe jo për të siguruar shërbime ose ndihmë për ndonjë person tjetër përveç përdoruesve tuaj të brendshëm. Përveç kur u tregohet ndryshe me shkrim, Softueri i BlackBerry i siguruar, nëse po, përmes Shërbimeve të Biznesit nga BlackBerry (nëse zbatohet) do të konsiderohet i dhënë me licënsë për ju me të njëjtat kushte si Softueri me të cilin ka lidhje.
3. Shërbimet fillojnë në datën kur Shërbimet vihen në dispozicion, me kusht që ju të veproni në përputhje me detyrimet tuaja në Pjesën 5 ("**Data e Fillimit**") dhe do të vazhdojnë për kohëzgjatjen e përcaktuar dhe nivelin e ndihmës që keni porositur në rast të ndihmës teknike ose në rast të shërbimeve të tjera deri në skadimin e periudhës së Shërbimit ose siç përcaktohet ndryshe. Nëse Shërbimi u sigurohet si pjesë e një periudhe abonimi, afati do të fillojë me abonimin. Atje ku lejohet dhe përcaktohet nga BlackBerry në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry, BlackBerry pas dhënies së njoftimit, do të rinovojë automatikisht afatin e zbatueshëm që keni blerë.
4. Të gjitha porositë që bëni për Shërbimet do të përfshijnë përmes referimit Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe do të përcaktojnë numrat e serisë për ndonjë BlackBerry Enterprise Server për të cilin ju keni nevojë për ndihmë teknike ose Shërbime të tjera, nëse Shërbime të tilla kanë lidhje me një BlackBerry Enterprise Server. Edhe nëse BlackBerry pranon ose përndryshe pranon porositë tuaja në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përmes një rishitësi të autorizuar nga BlackBerry, të gjitha kushtet standarte të shtypura të përfshira në porositë që bëni nuk do të konsiderohen të jenë pjesë e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry ose të modifikojnë ose t'u shtohen Kushteve të Shërbimeve të Biznesit nga BlackBerry ose kushteve të shërbimeve të tjera ose përndryshe të qeverisin marrëdhënien ndërmjet jush dhe BlackBerry në ndonjë mënyrë. Të gjitha kushtet e tjera në porosinë tuaj do të zbatohen vetëm deri në nivelin në të cilin janë pranuar shprehimisht me shkrim nga BlackBerry.
5. Ju do të paguani tarifën për Shërbimet tek BlackBerry ose një rishitës i autorizuar i Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry siç zbatohet, paraprakisht, neto tridhjetë (30) dita nga data e faturës. BlackBerry nuk do të rikthejë ndonjë para tek ju nëse gjatë Afatit, Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry u jepen fund ose vëllimi i Softuerit ose produkteve për të cilat sigurohen Shërbimet pakësohet. Nëse për çdo arsye, nuk keni paguar BlackBerry ose një rishitës të autorizuar të Shërbimeve, siç zbatohet, përpara Datës së Fillimit, BlackBerry rezervon të drejtën për të refuzuar që të sigurojë Shërbimet derisa të marrë pagesën e plotë. Nëse BlackBerry nuk e ushtron

këtë ose çdo të drejtë tjetër që ka sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry në një rast të caktuar, BlackBerry nuk do të parandalohet nga ushtrimi i kësaj të drejte në ndonjë rast të ardhshëm ose edhe në rastin konkret, përsa kohë që ju jep të paktën tridhjetë (30) ditë kohë me një njoftim me shkrim të vendimit të saj për t'a bërë këtë. Pranoni të veproni në përputhje me dhe do të jeni përgjegjës për të gjitha paraqitjet, regjistrimet, licencat, miratimet dhe pëlqimet e duhura në vendin ose juridiksionin tuaj në lidhje me nxjerrjen e parave jashtë nga vendi ose juridiksioni juaj , përfshirë nxjerrjen e fondeve të tilla në një monedhë të huaj.

6. Do të jeni përgjegjës për dhe do të paguani të gjitha taksat që detyroheni sipas ose në lidhje me Shërbimet. Përveç kur tregohet ndryshe, të gjitha shumat e pagueshme nga ju për BlackBerry ose një rishitës të autorizuar të Shërbimeve, siç zbatohet, sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry nuk përfshijnë ndonjë taksë, tatim, tarifë ose shumë të ngjashme të qeverisë që mund të vlerësohet nga çdo juridiksion, pavarësisht nëse mbështetet në të ardhurat bruto, dorëzimet, kryerjen ose përdorimin e Shërbimeve ose rezultatet e tyre, pranimin e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry ose përndryshe, përveç për ato që mbështeten në të ardhurat neto të BlackBerry. Nëse ju kërkohet të mbani ndonjë taksë nga pagesat që detyroheni të bëni sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry, atëherë shumat e pagesës që detyrohet do të rritet automatikisht për të balancuar një taksë të tillë, në mënyrë që shumat që aktualisht dorëzohen nga ju tek BlackBerry ose një rishitës i autorizuar i Shërbimeve, siç zbatohet, neto me të gjitha taksat e mbajtura, është e barabartë me shumën në faturë ose që përndryshe është e detyruar të bëhet. Duhet t'i siguroni BlackBerry menjëherë të gjitha faturat zyrtare që tregojnë pagimin e taksave që detyrohen ose që kanë lidhje me këto Kushte të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry tek autoriteti i duhur i taksave.
7. Shërbimet nuk përfshijnë BlackBerry dhënien e ndihmës për probleme që: (a) nuk pengojnë Softuerin ose produktin ose shërbimin tjetër nga funksionimi në mënyrë thelbësore në përputhje me dokumentacionin e siguruar nga BlackBerry; (b) rezultojnë nga përdorimi i Softuerit, produktit ose shërbimit në një mënyrë tjetër nga ajo e parashikuar shprehimisht nga dokumentacioni i siguruar nga BlackBerry; ose (c) rezultojnë nga faktorë të jashtëm ndaj produkteve dhe shërbimeve të BlackBerry si nga: (i) ndonjë Softuer të Palëve të Treta ose harduer (përfshirë rrjete me linjë ose me valë pavarësisht nëse problemi rezulton nga paraqitja e tyre, mos-paraqitja ose mungesa e gatishmërisë); (ii) ndërveprueshmëria e Softuerit me Softuer të Palëve të Treta ose harduer (përfshirë rrjete me linjë ose me valë); ose (iii) një Rast i Forcës Madhore siç përcaktohet më poshtë në Pjesën 18.
8. BlackBerry rezervon të drejtën për t'ju ngarkuar tarifa shtesë për ndonjë shërbim që u sigurohet nga BlackBerry dhe që miratohet paraprakisht nga ju, që nuk përfshihet në Shërbimet sipas nivelit të asaj kohe të BlackBerry për kryerjen e shërbimit të caktuar plus shpenzimet e tij që kanë lidhje me kryerjen e shërbimit (përfshirë ndonjë shpenzim të miratuar paraprakisht të udhëtimit nëse zbatohet). BlackBerry do t'ju japë njoftim me shkrim të qëllimit të tij për t'ju ngarkuar tarifën në këtë mënyrë përpara kryerjes së shërbimit ose sapo BlackBerry të përcaktojë se shërbimi është shprehimisht i përjashtuar sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry. Do të paguani të gjitha faturat e tilla neto tridhjetë (30) ditë nga data e faturës.
9. Pranoni t'i siguroni BlackBerry çdo informacion dhe/ose ndihmë që BlackBerry në mënyrë të arsyeshme kërkon për të diagnostifikuar problemet me Softuerin, produktin ose shërbimin dhe që përndryshe të përmbushë detyrimet e tij sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry. Pa kufizuar përgjithësimin e sa më sipër, kur kërkohet nga BlackBerry, ju duhet që, në kohën e duhur, t'i siguroni BlackBerry: (a) Rregjistrat tuaj për ndonjë softuer në pronësi të BlackBerry siç mund të kërkohet; (b) të gjitha materialet ose informacionin tjetër të nevojshëm që BlackBerry të kryejë Shërbimet; (c) personel të kualifikuar me përvojë për harduerin dhe softuerin tuaj ekzistues; dhe (d) përdorimin e arsyeshëm të mjediseve tuaja.

Përveç asaj që keni pranuar ose pranoni në një dhënie të veçantë të pëlqimit për konfidencialitetin si pjesë e procesit të aktivizimit ose rregjistrimit të Shërbimeve, kushtet e mëposhtme do të zbatohen për çdo informacion personal:

- a. Pranoni se rregjistrat, informacioni ose materiale të tjera që siguron për BlackBerry mund të përfshijnë informacion personal për ju, punonjësit tuaj, klientët tuaj ose persona të tjerë. Informacioni personal që mblidhet, përdoret, përpunohet, transferohet, ruhet dhe tregohet (së bashku, "Të përpunuar") nga Grupi i Kompanive të BlackBerry (që nënkupton BlackBerry dhe filialet dhe partnerët) dhe siguresit e shërbimit të saj do të trajtohen në përputhje me Praktikën e Konfidencialitetit të BlackBerry (e cila përfshihet këtu nëpërmjet referimit në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe mund të shihet tek www.blackberry.com/legal ose mund të merret duke dërguar një e-mail tek legal@blackberry.com dhe gjithashtu në përputhje me Marrëveshjen e Zgjidhjes së Liçensës të BlackBerry përfshirë pa kufizim Pjesët e quajtura "Pëlqimi për Mbledhjen, Përdorimin, Përpunimin, Transferimin, Ruajtjen dhe Tregimin e Informacionit" dhe "Të Dhënat e Përdoruesit"). Atje ku zbatohet, kontrolluesi i të dhënave në lidhje me të dhënat tuaja personale është njësia e BlackBerry me të cilën keni nënshkruar Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry; me kusht se, në lidhje me të dhënat tuaja personale të mbledhura në lidhje me shpërndarjen e Ofertave (të përkufizuara në Marrëveshjen e Zgjidhjes së Liçensës të BlackBerry) nëpërmjet një Dyqani RIME (të përkufizuar në Marrëveshjen e Zgjidhjes së Liçensës të BlackBerry), kontrolluesi i të dhënave është njësia përkatëse RIME me të cilën keni nënshkruar një marrëveshje që qeveris një shpërndarje të tillë. Pëlqimi dhe pranimi i Përpunimit të informacionit të tillë personal siç përshkruhet në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry, Marrëveshjen e Zgjidhjes së Licensës të BlackBerry dhe Praktikën e Konfidencialitetit të BlackBerry. BlackBerry dhe/ose Grupi i Kompanive të BlackBerry mund t'ju kontaktojë në lidhje me përdorimin prej jush të Shërbimeve dhe produkteve dhe shërbimeve që kanë lidhje dhe të komunikojnë me ju (përfshirë sondazhe të mëpasshme në lidhje me Shërbimet dhe produktet dhe shërbimet e tjera të BlackBerry).
 - b. Nëse jeni një banor i Rajonit Special Administrativ të Hong Kongut të Republikës Popullore të Kinës ("Hong Kong"), ju gjithashtu pranoni se BlackBerry mund të përpunojë, transmetojë dhe tregojë ndonjë "të dhënë personale" (siç përkufizohet në Urdhëresën e të Dhënave Personale (Konfidencialiteti) (Kapitulli 486 i Ligjeve të Hong Kongut)), përfshirë transmetimin e informacionit të tillë tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada ose ndonjë vend ose vende të tjera të emëruara nga BlackBerry herë pas here.
 - c. Nëse jeni një banor i Francës ose i rajoneve të saj përtej deteve, mund të ushtroni të drejtat tuaja të kundërshtimit, përdorimit dhe/ose korrigjimit të të dhënave tuaja personale duke dërguar një e-mail në legal@blackberry.com
10. Pranoni të veproni në përputhje me dhe të jeni përgjegjës për të gjitha ligjet, rregulloret, paraqitjet, rregjistrimet, liçensat, miratimet dhe pëlqimet e duhura në vendin ose juridiksionin tuaj përfshirë pa kufizim importimin, eksportimin ose ligjet dhe rregulloret e konfidencialitetit të të dhënave të zbatueshme për ju, ekzekutimin e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry nga ju dhe marrjen ose përdorimin e Shërbimeve nga ju, përfshirë pa kufizim transferimin ose dhënien e informacionit, teknologjisë, të dhënave ose informacionit personal tek BlackBerry.
11. Pranoni afatet dhe kushtet e mëposhtme të konfidencialitetit:

- a. Nëse keni nënshkruar një marrëveshje të mos-tregimit me BlackBerry (“**NDA**”), NDA do të zbatohet për Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe për marrjen nga ju të Shërbimeve dhe përfshihet këtu nga ky referim përveç se: (i) kushtet e NDA do të vazhdojnë të zbatohen për Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry për sa kohë që Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry mbeten në fuqi dhe afati i NDA do të zgjatet automatikisht deri në nivelin e nevojshëm për t'a bërë atë bashkë-ekzistues me Afatin, me kusht që kjo zgjatje të zbatohet vetëm në lidhje me Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry; dhe (ii) Informacioni Konfidencial (siç përkufizohet në NDA) që tregohet ose përndryshe zbulohet nëpërmjet marrjes nga ju të Shërbimeve mund të përdoret ose riprodhohet vetëm në nivelin e nevojshëm për të çuar më tej dhe për të përmbushur qëllimet e marrjes nga ju të Shërbimeve (të cilat do të konsiderohen të përfshira në përkufizimin e “**Qëllimit**” sipas NDA).
- b. Nëse nuk keni nënshkruar një NDA me BlackBerry, kjo Pjesë 11(b) do të zbatohet për Kushtet e Shërbimeve të Biznesit nga BlackBerry dhe për marrjen prej jush të Shërbimeve. Përveç siç lejohet posaçërisht në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry ose me lejen paraprake të shprehur me shkrim, Palët nuk do të tregojnë, nuk do të lejojnë përdorimin, transmetimin, transferimin ose përndryshe nuk do të vendosin në dispozicion ndonjë Informacion Konfidencial, siç përkufizohet më poshtë, tek një palë e tretë. Pavarësisht nga sa më sipër, Palët mund të zbulojnë Informacionin Konfidencial nëse dhe vetëm në nivelin që është: (i) kërkuar të bëhet kështu nga ligji me kusht që Pala i jep Palës tjetër njoftim të mjaftueshëm për të lejuar Palën tjetër që të kërkojë një urdhër që kufizon ose përjashton një tregim të tillë; ose (ii) i nevojshëm për të çuar më tej dhe për të përmbushur qëllimet e marrjes nga ju të Shërbimeve (“**Qëllimi i Lejueshëm**”). Asnjëra Palë nuk do të përdorë ose nuk do të riprodhojë Informacionin Konfidencial për ndonjë arsye përveç atyre që janë të nevojshme në mënyrë të arsyeshme për të përmbushur Qëllimin e Lejueshëm.

“**Informacioni Konfidencial**” përkufizohet këtu si çdo informacion në çfarëdo formë ose mjet (dhe përfshin të gjitha kopjet e informacionit të tillë që Palët janë të autorizuar të bëjnë këtu) që është: në pronësi ose konfidencial për Palët përfshirë, pa kufizim, informacionin që është përfshirë në ose ka lidhje me të gjitha faqet në internet, softuerin ose materiale të tjera të cilat Palëve u është dhënë mundësia e përdorimit nga marrja prej jush e Shërbimeve; dhe drejtpërdrejt ose të tërthortë tregohet ose të cilave Palëve përndryshe u jepet mundësia e përdorimit otherwise provided access.

Informacioni Konfidencial që një Palë mund të përcaktojë: është në mënyrë të ligjshme në posedim të asaj Pale përpara marrjes nga BlackBerry; ose është ose bëhet një çështje e njohurisë publike jo për shkak të fajit të një Pale; nuk do të konsiderohet Informacion Konfidencial sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry.

Detyrat e Palëve në lidhje me Informacionin Konfidencial sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry do të vazhdojnë të zbatohen për marrjen nga ju të Shërbimeve përsa kohë që Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry mbeten në fuqi.

12. Ligji qeverisës, zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe vendi për Kushtet e Shërbimeve të Biznesit nga BlackBerry do të jenë si më poshtë:
 - a. Atje ku adresa juaj kryesore është në Kanada, Amerikën e Jugut ose kudo që nuk përmendet në (2) deri në (4) më poshtë, Kushtet e Ndihmës Teknike do të qeverisen nga

dhe do të përcaktohet sipas ligjeve të Provincës së Ontarios, Kanada. Secila Palë këtu heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga të gjitha kundërshtimet mbi bazën e vendit, joleverdisshmëria e forumit ose ndonjë bazë tjetër të ngjashme dhe jep pëlqimin në mënyrë të pakthyeshme për shërbimin e procesit nëpërmjet postës ose në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar sipas ligjit të zbatueshëm dhe jep pëlqimin për juridiksionin e gjykatave të Provincës së Ontarios, Kanada. Palët më tej këtu heqin dorë nga çdo e drejtë për një gjyq me juri në lidhje me ndonjë padi ligjore ose procedim gjyqësor që del ose ka lidhje me Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry.

- b. Atje ku adresa juaj kryesore është në Evropë (përfshirë Grinland dhe territoret, protektoratet ose rajonet përtej detrave të vendeve evropiane), Lindjen e Mesme ose Afrikë ose Federatën Ruse, Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry do të qeverisen nga dhe do të përcaktohen në përputhje me të drejtën angleze dhe gjykatat e Anglisë do të kenë juridiksionin ekskluziv për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që del ose ka lidhje me Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe Palët këtu pranojnë t'i nënshtrohen juridiksionit të gjyqeve të Anglisë. Palët e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry nuk synojnë që ndonjë prej kushteve të tyre të jenë të detyrueshme sipas Ligjit të Kontratës (të Drejtat e Palëve të Treta) (MB) 1999 nga ndonjë person që nuk është një Palë e tyre.
 - c. Atje ku adresa juaj kryesore është në Azinë e Paqësorit (përfshirë Pakistanin, Sri Lankën, Kazakistanin, Kirgistanin, Taxhikistanin, Turkmenistanin dhe Uzbekistanin), Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry do të qeverisen nga dhe do të përcaktohen në përputhje me ligjet e Republikës së Singaporit. Gjykatat e Republikës së Singaporit do të kenë juridiksionin ekskluziv për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që del ose ka lidhje me Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe Palët këtu pranojnë t'i nënshtrohen juridiksionit të gjyqeve të Republikës së Singaporit. Palët e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry nuk synojnë që ndonjë prej kushteve të tyre të jenë të detyrueshme sipas Ligjit të Kontratës (të Drejtat e Palëve të Treta) (Kap. 53B) (Singapori) nga ndonjë person që nuk është një Palë e tyre.
 - d. Atje ku adresa juaj kryesore është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (përfshirë territoret, protektoratet ose rajonet përtej detrave të saj), Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry do të qeverisen nga dhe do të përcaktohen në përputhje me ligjet e Shtetit të Nju Jorkut, Shtetet e Bashkuara. Secila Palë këtu heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga të gjitha kundërshtimet mbi bazën e vendit, joleverdisshmëria e forumit ose ndonjë bazë tjetër të ngjashme dhe jep pëlqimin në mënyrë të pakthyeshme për shërbimin e procesit nëpërmjet postës ose në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar sipas ligjit të zbatueshëm dhe jep pëlqimin për juridiksionin e gjykatave të Shtetit të Nju Jorkut, Shtetet e Bashkuara. Palët më tej këtu heqin dorë nga çdo e drejtë për një gjyq me juri në lidhje me ndonjë padi ligjore ose procedim gjyqësor që del ose ka lidhje me Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry.
13. Pranoni dhe bini dakort se nuk merrni ndonjë pronësi intelektuale ose të drejta të tjera të pronësisë, përfshirë pa kufizim patenta, informacion industrial, jokonkret, skica, marka tregtare, të drejtën e autorit, morale, sekret tregtar, informacion konfidencial ose të drejta të tjera ("**Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale**") në ose në lidhje me Shërbimet, Informacionin Konfidencial të BlackBerry ose ndonjë përkthim ose punë tjetër që rrjedh nga ajo. Pranoni se asgjë në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry nuk do të ndikojë negativisht ndonjë prej të drejtave dhe rekursin e ndonjë prej mjeteve që BlackBerry mund të ketë sipas ligjeve në vendin ose juridiksionin tuaj që ka lidhje me mbrojtjen e Të Drejtave të Pronësisë Intelektuale të BlackBerry.

Pranoni se nuk do të ose nuk do të shkaktoni që të tjerë të rregjistrojnë në mënyra të ndryshme pranë autoriteteve përkatëse ndonjë aspekt të Shërbimeve, Informacionin Konfidencial të BlackBerry si dhe ndonjë softuer ose materiale që kanë lidhje me to (përfshirë pa kufizim ndonjë përkthim ose punë tjetër që rrjedh nga Shërbimet, Informacioni Konfidencial i BlackBerry, ndonjë softuer ose materiale që kanë lidhje me to) me qëllim marrjen e ndonjë të Drejte të Pasurisë Intelektuale, përveç kur, me kërkesën me shkrim të BlackBerry, mund të rregjistroji në mënyra të ndryshme Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry Terms vetëm me qëllimin e lehtësimit të dërgimit të pagesave. Nëse merrni ose përdorni Shërbimet ose jeni banor në një vend ose juridiksion që nuk ka në fuqi legjislacion të së drejtës së autorit ose për të cilin legjislacioni i të drejtës së autorit nuk zbatohet për softuerin, atëherë, përveç ndonjë detyrimi tjetër që mund të keni sipas ligjeve të zbatueshëm në vendin ose juridiksionin tuaj, pranoni shprehimisht se *Ligji i të Drejtës së Autorit të Kanadasë* do të konsiderohet se zbatohet për ju dhe marrjen dhe përdorimin prej jush të Shërbimeve. Nëse shkelni, përdorni keq ose përndryshe shkelni informacionin konfidencial, pronësinë intelektuale ose të drejtat e tjera të pronësisë të BlackBerry (së bashku “**Shkelje e IP**”) dhe një gjykatë në juridiksionin tuaj nuk është në gjendje ose nuk është e gatshme të japë një urdhër ndalues për të ndaluar një Shkelje të tillë të IP, pranoni se BlackBerry do të ketë të drejtën që të marrë dëme të likuiduara nga ju në shumën 5,000 dollarë amerikanë në ditë gjatë periudhës së Shkeljes së tillë të IP.

14. Deri në masën që ndonjë pjesë, klauzolë, dispozitë ose fjali ose pjesë e tyre (“Pjesë”) e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry përcaktohet të jetë e paligjshme, e pavlefshme ose e padetyrueshme nga një autoritet kompetent në ndonjë juridiksion, atëherë një përcaktim i tillë i asaj Palë nuk do të prekë: (i) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose detyrueshmërinë e Pjesëve të mbetura të Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry; ose (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose detyrueshmërinë e asaj Pjesë në ndonjë juridiksion tjetër dhe se ajo Pjesë do të kufizohet nëse është e mundshme dhe vetëm më pas do të pritët, nëse është e nevojshme, deri në masën që kërkohet për të bërë Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry të vlefshme dhe të detyrueshme.

15. NESE JENI NJE BANOR I NDONJE JURIDIKSIONI PERVEÇ GJERMANISE DHE AUSTRISE, ATEHERE:

- a. PERVEÇSE DERI NE MASEN E NDALUAR POSATÇERISHT NGA LIGJI I ZBATUESHEM NE VENDIN OSE JURIDIKSIONIN TUAJ DHE PERVEÇSE SIÇ PERCAKTOHET SHPREHIMISHT NE KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY, BLACKBERRY NUK BEN ASNJE PERFAQESIM, GARANCI, MBESHTETJE, GARANCI, SIGURI OSE KUSHTE CILATDOQOFTE, TE SHPREHURA OSE TE NENKUPTUARA, NE LIDHJE ME SHERBIMET.
- b. PERVEÇSE DERI NE MASEN E NDALUAR POSATÇERISHT NGA LIGJI I ZBATUESHEM NE VENDIN OSE JURIDIKSIONIN TUAJ, NE ASNJE RAST BLACKBERRY NUK DO TE KONSIDEROHET PERGJEGJES NDAJ JUSH PER, DHE KETU HIQNI DORE NGA TE GJITHA DEMET E TERTHORTA, EKONOMIKE, SPECIALE, TREGTARE, TE RASTESISHME, TE RRALLA OSE TE MEPASSHME (PERFSHIRE PA KUFIZIM PERFITIME TE HUMBURA, HUMBJE TE TE ARDHURAVE OSE FITIMEVE NGA BIZNESI, TE DHENA TE HUMBURA, DEME TE SHKAKTUARA NGA VONESA OSE NJE MOSARRITJE E REALIZIMIT TE KURSIMEVE TE PRITSHME) QE RRJEDHIN DREJTPERDREJT OSE NE MENYRE TE TERTHORTE NGA OSE NE LIDHJE ME KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY, PAVARESISHT NESE DEME TE TILLA MUND TE PARASHIKOHEN NE MENYRE TE ARSYESHME OSE SHANSI I TYRE I ESHTE TREGUAR BLACKBERRY.

- c. PERVEÇSE DERI NE MASEN E NDALUAR POSATÇERISHT NGA LIGJI I ZBATUESHEM NE VENDIN OSE JURIDIKSIONIN TUAJ, NE ASNJE RAST BLACKBERRY NUK DO TE KONSIDEROHET PERGJEGJES NDAJ JUSH OSE NDONJE PALE TE TRETE QE PRETENDON PERMES JUSH, PER TE GJITHA DEMET E ÇDO LLOJI QE KAPERCEJNE SHUMAT E PAGUARA NGA JU NE LIDHJE ME SHERBIMET GJATE AFATIT NE TE CILIN NDODHI INCIDENTI QE SHKAKTOI PERGJEGJESINE.
- d. KUFIZIMET, PERJASHTIMET DHE MOHIMET E PERGJEGJESISE TE PERCAKTUARA NE KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT NGA BLACKBERRY DO TE ZBATOHEN: (A) PAVARESISHT NESE NJE VEPRIM, PRETENDIM OSE KERKESE VJEN NGA NJE SHKELJE E GARANCISE OSE KUSHTIT, SHKELJE E KONTRATES, DEME (PERFSHIRE NEGLIZHENCE), PERGJEGJESI E RREPTE OSE NDONJE LLOJ TJETER TE PERGJEGJESISE CIVILE OSE LIGJORE QE KA LIDHJE ME OSE DEL NGA KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT NGA BLACKBERRY; DHE (B) PER BLACKBERRY DHE KOMPANITE PARTNERE TE SAJ SI DHE DREJTORET, ZYRTARET, PUNONJESIT DHE KONTRAKTORET E PAVARUR TE BLACKBERRY DHE KOMPANI TE TILLA PARTNERE. DISA JURIDIKSIONE NUK LEJOJNE KUFIZIM OSE PERJASHTIM TE DISA LLOJE TE DEMEVE DHE/OSE KUSHTEVE TE NENKUPTUARA OSE GARACIVE. KUFIZIMET, PERJASHTIMET DHE MOHIMET E PERGJEGJESISE TE PERCAKTUARA NE KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY NUK DO TE ZBATOHEN VETEM NESE DHE DERI NE MASEN QE LIGJET E NJE JURIDIKSIONI KOMPETENT KERKON PERGJEGJESI PERTEJ DHE PAVARESISHT NGA KETO KUFIZIME, PERJASHTIME DHE MOHIME TE PERGJEGJESISE. PRANONI DHE BINI DAKORT SE KUFIZIMET, PERJASHTIMET DHE MOHIMET E PERGJEGJESISE NE KETE PJESE PERBEJNE NJE ELEMENT THELBESOR TE KUSHTEVE TE SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY DHE SE NE MUNGESHE TE KUFIZIMEVE, PERJASHTIMEVE DHE MOHIMEVE TE PERGJEGJESISE TE TILLA TARIFAT DO TE JENE NE MENYRE THELBESORE ME TE LARTA DHE MUND TE NDIKOJNE NE AFTESINE E BLACKBERRY PER TE OFRUAR DHE AFTESINE TUAJ PER TE MARE DHE PER TE PERDORUR SHERBIMET NE JURIDIKSIONIN TUAJ.
- e. DUKE IU NENSHTRUAR NEN-PJESEVE TE MESIPERME (a) DERI NE (d), PJESES 7 DHE PJESES 18, BLACKBERRY DO TE SIGUROJE SHERBIMET DUKE PERDORUR KUJDESIN DHE AFTESINE E ARSYESHME TE TIJ.

16. NESE JENI NJE BANOR I GJERMANISE OSE AUSTRISE, ATEHERE:

- a. PERVEÇSE SIÇ PERCAKTOHET SHPREHIMISHT NE KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY, BLACKBERRY NUK BEN ASNJE PERFAQESIM, GARANCI, MBESHTETJE, GARANCI, SIGURI OSE KUSHTE CILATDOQOFTE, TE SHPREHURA OSE TE NENKUPTUARA, NE LIDHJE ME SHERBIMET.
- b. NE ASNJE RAST BLACKBERRY NUK DO TE KONSIDEROHET PERGJEGJES NDAJ JUSH PER, DHE KETU HIQNI DORE NGA TE GJITHA DEMET E TERTHORTA, EKONOMIKE, SPECIALE, TREGTARE, TE RASTESISHME, TE RRALLA OSE TE MEPASSHME (PERFSHIRE PA KUFIZIM PERFITIME TE HUMBURA, HUMBJE TE TE ARDHURAVE OSE FITIMEVE NGA BIZNESI, TE DHENA TE HUMBURA, DEME TE SHKAKTUARA NGA VONESA OSE NJE

MOSARRITJE E REALIZIMIT TE KURSIMEVE TE PRITSHME) QE RRJEDHIN DREJTPERDREJT OSE NE MENYRE TE TERTHORTE NGA OSE NE LIDHJE ME KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY, PAVARESISHT NESE DEME TE TILLA MUND TE PARASHIKOHEN NE MENYRE TE ARSYESHME OSE SHANSI I TYRE I ESHTË TREGUAR BLACKBERRY.

- c. NE ASNJE RAST BLACKBERRY NUK DO TE KONSIDEROHET PERGJEGJES NDAJ JUSH OSE NDONJE PALE TE TRETË QE PRETENDON PERMES JUSH, PER TE GJITHA DEMET E ÇDO LLOJI QE KAPERCEJNE SHUMAT E PAGUARA NGA JU NE LIDHJE ME SHERBIMET GJATE AFATIT NE TE CILIN NDODHI INCIDENTI QE SHKAKTOI PERGJEGJESINE.
 - d. KUFIZIMET, PERJASHTIMET DHE MOHIMET E PERGJEGJESISE TE PERCAKTUARA NE KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT NGA BLACKBERRY DO TE ZBATOHEN: (A) PAVARESISHT NESE NJE VEPRIM, PRETENDIM OSE KERKESE VJEN NGA NJE SHKELJE E GARANCISE OSE KUSHTIT, SHKELJE E KONTRATES, DEME (PERFSHIRE NEGLIZHENCE), PERGJEGJESI E RREPTE OSE NDONJE LLOJ TJETER TE PERGJEGJESISE CIVILE OSE LIGJORE QE KA LIDHJE ME OSE DEL NGA KUSHTET E SHERBIMEVE TE BIZNESIT NGA BLACKBERRY; DHE (B) PER BLACKBERRY DHE KOMPANITE PARTNERE TE SAJ SI DHE DREJTORET, ZYRTARET, PUNONJESIT DHE KONTRAKTORET E PAVARUR TE BLACKBERRY DHE KOMPANI TE TILLA PARTNERE. DISA JURIDIKSIONE NUK LEJOJNE KUFIZIM OSE PERJASHTIM TE DISA LLOJE TE DEMEVE DHE/OSE KUSHTEVE TE NENKUPTUARA OSE GARACIVE. PRANONI DHE BINI DAKORT SE KUFIZIMET, PERJASHTIMET DHE MOHIMET E PERGJEGJESISE NE KETE PJESE PERBEJNE NJE ELEMENT THELBESOR TE KUSHTEVE TE SHERBIMEVE TE BIZNESIT TE BLACKBERRY DHE SE NE MUNGËSE TE KUFIZIMEVE, PERJASHTIMEVE DHE MOHIMEVE TE PERGJEGJESISE TE TILLA TARIFAT DO TE JENE NE MENYRE THELBESORE ME TE LARTA DHE MUND TE NDIKOJNE NE AFTESINE E BLACKBERRY PER TE OFRUAR DHE AFTESINE TUAJ PER TE MARE DHE PER TE PERDORUR SHERBIMET NE JURIDIKSIONIN TUAJ.
 - e. DUKE IU NENSHTRUAR NEN-PJESEVE TE MESIPERME (a) DERI NE (d), PJESES 7 DHE PJESES 18, BLACKBERRY DO TE SIGUROJE SHERBIMET DUKE PERDORUR KUJDESIN DHE AFTESINE E ARSYESHME TE TIJ.
17. Pranoni se Shërbimet që mund të përfshijnë teknologji, të dhëna ose informacion janë me origjinë kanadeze dhe mund t'u nënshtrohen kufizimeve mbi eksportimin ose ri-eksportimin tek vendet që u nënshtrohen embargove kanadeze ose tek personat ose njësitë që janë ndaluar nga marrja e eksporteve kanadeze (përfshirë, por jo të kufizuara në, ato të përfshira me teknologji të raketave ose armë bërthamore, kimike ose biologjike) ("**Kontrolle të Eksportit**"). Përfaqësoni se: (a) me sa keni njohuri marrja dhe përdorimi nga ju e Shërbimeve nuk shkel Kontrollin e Eksportit; (b) nuk do të importoni, eksportoni, ose ri-eksportoni Shërbimet në ndonjë vend ose person duke shkelur Kontrollin e Eksportit; dhe (c) do të siguroni se përdoruesit tuaj të autorizuar marrin dhe përdorin Shërbimet në përputhje me Kontrollin e Eksportit.
18. Përveç detyrimeve të pagesës në Pjesët 5 dhe 6 më sipër, asnjë nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse për mosarritjen prej saj të kryerjes ose kryerjen e vonuar të detyrimit të saj sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit nëse mosarritje të tilla rezultojnë nga rrethana përtej kontrollit të arsyeshëm të Palësë prekur, përfshirë por jo të kufizuar në greva të furnitorëve, bllokime dhe mosmarrëveshje

të punës, akte të Zotit, luftë, protesta, trazira civile, vepra të terrorizmit, dëmtim keqdashës, veprimi në përputhje me ndonjë ligj ose urdhër, rregull, rregullore ose udhëzim qeveritar që nuk ishte në fuqi në Datën e Fillimit, aksident, zjarr, përmytje ose kushte të motit të ashpër (“**Rast i Forcës Madhore**”). Secila Palë pranon t’i japë Palës tjetër njoftim të menjëhershëm për çdo Rast të Forcës Madhore (që përmban hollësi të mjaftueshme). Në një Rast i Forcës Madhore vazhdon për më shumë se tridhjetë (30) ditë pune, secila Palë do të ketë të drejtën të përfundojë kontratën, pa përgjegjësi të mëtejshme ndaj tjetrës.

19. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër i kërkuar ose i lejuar këtu do të jetë me shkrim dhe do të jepet në mënyrë të mjaftueshme nëse jepet me dorë ose dërgohet me postë të rregjistruar, korrier, e-mail ose faks (me kusht që marrësi të njoftojë marrjen e faksit ose e-mailit në njëfarë mënyre ose që një paketë e korrierit elektronik të përdoret për të transmetuar njoftimin) të adresuar për Palën tjetër në adresën e treguar nga Palët herë pas here. Çdo njoftime, kërkesa ose komunikime të tjera do të konsiderohen të jenë dorëzuar kur merren nga Pala të cilës iu adresuan.
20. Gjatë afatit të Marrëveshjes (dhe për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj më pas), nëse sipas opinionit të arsyeshëm të BlackBerry është e nevojshme të bëhet kështu, BlackBerry do të ketë të drejtë, me shpenzimet e tij, të kryejë kontrolle për të vlerësuar veprimin tuaj në përputhje me Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry. Do t’i jepni BlackBerry mundësinë e arsyeshme të përdorimit dhe ndihmë siç kërkohet në mënyrë që të përfundohen kontrolle të tilla. Cdo kontroll i tillë do të kryhet gjatë orëve të rregullta të biznesit nga kontrollorë të pranueshëm në mënyrë të arsyeshme nga ju. Nëse, sipas opinionit të arsyeshëm të BlackBerry, një kontroll zbulon mospërputhje të rëndësishme, do të paguani kostot e arsyeshme të BlackBerry për kryerjen e kontrollit.
21. Nëse Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry përkthehen në një gjuhë tjetër përveç anglishtes, versioni në anglisht do të mbizotërojë deri në masën që ka ndonjë konflikt ose mospërputhje në kuptimin ndërmjet versionit në anglisht dhe çdo përkthim atje.
22. Nëse shkelni Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry, BlackBerry mundet, përveç të gjitha të drejtave dhe masave të tjera të siguruara në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry ose nga ligji, të përfundojë Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe t’i japë fund sigurimit të Shërbimeve. Çdo përfundim sipas Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry nga BlackBerry do të hyjë në fuqi pa marë nga BlackBerry të ndonjë pëlqimi, miratimit ose zgjidhje gjyqësore ose administrative ciladoqoftë në juridiksionin tuaj.
23. Palët pranojnë dhe bien dakort se nuk janë mbështetur në ndonjë komunikim, përfaqësim, garanci, kushte ose marrëveshje paraprake ose të tanishme qoftë me gojë ose me shkrim, së bashku ose përndryshe (së bashku “Deklarata Para-Kontraktuale”) në nënshkrimin e Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry dhe kështu Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry (përfshirë pa kufizim ndonjë NDA ose kushte të tjera të përfshira përmes referimit në Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry) ndërmjet Palëve përbëjnë marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve. Kushtet e Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry mbizotërojnë çdo komunikim, përfaqësim, garanci, kushte ose marrëveshje paraprake ose të tanishme ndërmjet Palëve, qoftë me gojë ose shkrim, kolaterale ose përndryshe, në lidhje me çështjen e subjektit të Kushteve të Shërbimeve të Biznesit të BlackBerry. Palët pranojnë dhe bien dakort se do të: (a) trajtojnë çdo Deklaratë Para-Kontraktuale të tillë si të tërhequr dhe që ka pasojën se nuk është bërë kurrë; dhe (b) nuk kanë asnjë të drejtë ose masë në lidhje me Deklarata Para-Kontraktuale të tilla. Asgjë në këtë Pjesë nuk do të funksionojë për të kufizuar ose përjashtuar ndonjë përgjegjësi për mashtrim.